

CEO-të në Shqipëri janë pesimistë për rritjen ekonomike për vitin e ardhshëm, ndërkohë që nënvizojnë nevojën urgjente për transformim – Anketa e 26-të e CEO-ve në Shqipëri nga PwC.

- **Inflacioni (cituar nga 83%), paqëndrueshmëria makroekonomike (68%), konflikti gjeopolitik (57%) dhe rreziku kibernetik (59%) renditen si kërcënimet kryesore midis CEO-ve shqiptarë, nga ku rreziku shëndetësor dhe ndryshimet klimatike bien nga renditja e një vit më parë.**
- **46% e CEO-ve në Shqipëri po ulin kostot, 34% po rrisin çmimet, megjithatë 78% nuk planifikojnë të ulin numrin e punonjësve dhe 76% nuk planifikojnë të ulin kompensimin.**
- **Mungesa e fuqisë punëtore/punëtorëve të kualifikuar shihen si sfidat më të mëdha për fitimet afatgjate të industrive për CEO-t në Shqipëri.**
- **59% e drejtorëve ekzekutivë në Shqipëri planifikojnë të investojnë në automatizimin e proceseve dhe sistemeve në 12 muajt e ardhshëm.**
- **Rreth 46% e CEO-ve në Shqipëri nuk mendojnë se kompanitë e tyre do të jenë ekonomikisht të qëndrueshme pas një dekade nëse vazhdojnë në rrugën e tyre aktuale.**

Prill, 2023 – Rreth tre të katërtat (73%) e CEO-ve në Shqipëri besojnë se rritja ekonomike globale do të bjerë gjatë 12 muajve të ardhshëm. Kjo është ndër gjetjet kryesore të Anketës së 26-të Vjetore të CEO-ve në Shqipëri nga PwC. Në nivel global, PwC anketoi 4,410 CEO në 105 vende dhe territore në tetor dhe nëntor 2022 nga ku 41 CEO ishin nga Shqipëria.

Kjo është një pikëpamje pesimiste në lidhje me rritjen ekonomike globale dhe përfaqëson një ndryshim të mprehtë nga viti i kaluar, ku 66% e drejtuesve të biznesit në vend parashikuan një përmirësim/rritje të ekonomisë globale.

Drejtimesit shqiptarë janë pak më pak pesimistë për rritjen ekonomike të vendit të tyre: 59% e tyre besojnë se rritja do të ngadalësohet. Ndërkaq, drejtorët ekzekutivë shqiptarë janë më të sigurtë për rritjen e kompanisë së tyre dhe po shohin për mundësi të tjera zhvillimi në vendet më të afërta gjeografikisht.

Pavarësisht pesimizmit të tyre për kushtet makroekonomike, CEO-t janë më të sigurtë kur bëhet fjalë për gjëra të cilat ata mund t'i kontrollojnë drejtpërdrejtë: CEO-t tanë janë më të sigurtë për perspektivat e rritjes së të ardhurave të kompanisë së tyre përgjatë 12 muajve të ardhshëm, nga ku 22% thonë se janë "jashtëzakonisht të sigurtë". Optimizmi i tyre është edhe më i madh kur e shikojmë në një horizont trevjeçar – 32% e tyre thonë se janë të sigurtë në rritjen e kompanisë së tyre.

Nuk është për t'u habitur që liderët botëror po shohin më afër vendit se kurrë më parë për mundësitë e zgjerimit jashtë vendit. Tronditja nga pandemia dhe trazirat e vazhdueshme gjeopolitike na lënë të kuptojmë se kompanitë në mbarë botën po kërkojnë mënyra për të afuar marrëdhëniet e tyre të biznesit - duke shkurtuar dhe forcuar kështu zinxhirët e tyre të furnizimit. Kompanitë shqiptare nuk janë ndryshe, edhe tek CEO-t shqiptar vihet re ky trend.

Në anketën e këtij viti, Italia është ende një nga vendet kryesore që konsiderohet e rëndësishme për rritje - për 22% të CEO-ve shqiptarë. Gjithashtu, vihet re një rritje e përqendrimit në Gjermani (27%). Brenda rajonit, udhëheqësit e biznesit treguan interes për Kosovën (20%), Greqinë (15%), Austrinë (15%) dhe Maqedoninë e Veriut (12%) – duke reflektuar sërish trendin e interesit për vendet më afër gjeografikisht.

Inflacioni, paqëndrueshmëria makroekonomike dhe konflikti gjeopolitik kryesojnë shqetësimet e CEO-ve

Rënia ekonomike ka një ndikim të madh mbi CEO-të këtë vit, inflacioni (83%), paqëndrueshmëria makroekonomike (68%) dhe konflikti gjeopolitik (57%) udhëheqin rreziqet të cilat rëndojnë mbi CEO-të në periudhën afatshkurtër - 12 muajt e ardhshëm. Në kontrast me CEO-t në rajon dhe në botë, CEO-t shqiptarë e konsiderojnë rrezikun kibernetik si një nga shqetësimet e tyre kryesore (59%).

Megjithatë, drejtuesit e perceptojnë inflacionin si një kërcënim relativisht kalimtar: ndikimi i tij për pesë vitet e ardhshme bie në 39%. Paqëndrueshmëria makroekonomike gjithashtu ulet në 32%. Ndërkohë rreziku gjeopolitik zbret në 17%. Gjithashtu rreziku kibernetik zvogëlohet në 32%.

Drejtoret ekzekutive po rrisin çmimet dhe po ulin kostot – por shumica nuk planifikojnë të reduktojnë numrin e punonjësve

Në përgjigje ndaj sfidave ekonomike afatshkurtëra, CEO-t në Shqipëri janë në përputhje me kolegët globalë përsa i përket vendimeve të cilat nxisin rritjen e të ardhurave dhe ulin kostot. Një veprim bie në sy: 46% e CEO-ve në vendin tonë thonë se tashmë kanë reduktuar kostot operacionale – një mjet që deri më tani 52% e kolegëve të tyre globalë e kanë përdorur.

Si në Shqipëri ashtu edhe në nivelin global, tronditja nga “Dorëheqja e Madhe” si dhe nevoja e vazhdueshme për të tërhequr dhe mbajtur talentet po formësojnë përgjigjen ndaj sfidave makroekonomike. Si pasojë, 34% e kompanive kanë rritur tashmë çmimet e tyre dhe 34% janë përpjekur të diversifikojnë produktet e tyre, 10% po zbatojnë ngrirjen e punësimeve, vetëm 7% kanë ngadalësuar investimet, vetëm 5% po zvogëlojnë numrin e punëtorëve dhe vetëm 5% po ulin kompensimin.

Nevoja urgjente për transformim

Përveç një mjedisi sfidues, gati 46% e CEO-ve në Shqipëri mendojnë se organizatat e tyre nuk do të jenë ekonomikisht të qëndrueshme në një dekadë prej tash nëse vazhdojnë në rrugën e tyre aktuale. Drejtuesit e shohin nevojën për ndryshim dhe po mendojnë gjithashtu për hapat që u duhen ndjekur për të arritur atje.

Një ndër kërcënimet kryesore ndaj bizneseve të CEO-ve në vendin tonë, është mungesa e fuqisë punëtorë të kualifikuar – kjo është pjesë e luftës së vazhdueshme globale për talentet dhe është e evidente në sondazhet e CEO-ve prej disa vitesh tashmë.

Ndër rreziqet e tjera përfshihen ndryshimi i preferencave të klientëve (në Shqipëri: 37%, globalisht: 56%) dhe ndryshimet në teknologji, p.sh. teknologjia e avancuar, AI, metaverse, blockchain (në Shqipëri: 37%, globalisht: 49%).

Për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive këtyre sfidave, CEO-t po përpiqen të jenë më të qëndrueshëm sot. Investimet që po orientohen kundrejt teknologjisë janë të mëdha për shumë CEO globalë gjithashtu dhe shqiptarë. Në territorin tonë, drejtuesit e bizneseve po planifikojnë të investojnë më shumë në automatizim, duke përdorur teknologji (cloud, AI, etj.) në 12 muajt e ardhshëm.

Pavarësia energjetike është një prioritet në rritje për liderët në rajonin tonë

Drejtoret ekzekutive janë gjithashtu në kërkim të burimeve të reja të energjisë, pasi pushtimi rus i Ukrainës ishte një thirrje zgjimi për shumë vende të cilat vareshin shumë nga gazi rus. Në anketën e këtij viti, 39% e CEO-ve në Shqipëri thanë se kalimi në burime të reja energjetike do të ndikojë në biznesin e tyre në 10 vitet e ardhshme, në thelb pak më shumë se 37% e liderëve globalë e parashikojnë këtë efekt. Dhe 37% e drejtuesve të bizneseve në Shqipëri (globalisht: 34%) planifikojnë të investojnë në burime alternative të energjisë në 12 muajt e ardhshëm. Kjo është një shenjë inkurajuese e cila gjithashtu do të rrisë aftësinë e kompanive për t'iu përgjigjur sfidave të cilat lidhen me ndryshimet klimatike.

Shënime:

Rezultatet e plota të sondazhit janë në dispozicion në: [link](#)

Rreth të dhënave: PwC anketoi në nivel global 4,410 CEO në tetor dhe nëntor 2022. Në këtë grup ishin 41 CEO nga Shqipëria.

Rreth PwC: Në PwC, qëllimi ynë është të krijojmë besim në shoqëri dhe të zgjidhim probleme të rëndësishme. Ne jemi një rrjet firmash në 152 vende me afro 328,000 njerëz të cilët janë të përkushtuar për të ofruar cilësi në shërbimet e auditimit, këshillimit financiar, fiskal dhe ligjor. Prezenca jonë në Shqipëri është nga viti 2005. Për më tepër mbi ne dhe shërbimet tona, vizitoni: www.pwc.com/al

© 2023 PwC. Të gjitha të drejtat e rezervuara. PwC i referohet rrjetit PwC dhe/ose një ose më shumë firmave anëtare të saj, secila prej të cilave është një ndërrmarje juridike e veçantë. Ju lutemi shikoni www.pwc.com/structure për detaje të mëtejshme.